



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 27.02.2023

Nr: 15

Ora: 13:45

VENDIM I NDËRMJETËM

**PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE NR. 6 DHE NR. 9, DATË 17.02.2023
TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 27.02.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 6 dhe 9, datë 17.02.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 27.02.2023 Nr: 15
Ora: 13:45



Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 6 dhe nr. 9, datë 17.02.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 06 regj., datë 17.02.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 09 regj., datë 17.02.2023.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 27.02.2023, me vendimet nr. 9 dhe nr. 12, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ në datën 17.02.2023. Relatorët e kërkesave ankimore përkatësisht z. Elvis Çefa dhe z. Elvin Lako kakanstatuan se të dy kërkesat kishin të njëjtin objekt: Vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Arisa Toska, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat, për mosraportim të veprimtarive publike brenda afatit ligjor.

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave nr. 6 dhe nr. 9 të paraqitura nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datë 17.02.2023 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 6, datë 17.02.2023 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 9, datë 17.02.2023, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Elvis Çefa.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave nr. 6, datë 17.02.2023 dhe nr. 9, datë 27.02.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 28.02.2023 ora 12:45;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**